



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr._____, datë_____.____2021

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 13/2015 “PËR POLICINË
USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pas fjalës “shërbim”, të shtohet fjala “stërvitje...”.

Neni 2

Në nenin 4, pas fjalës “specializuar”, të shtohen fjalët “për veprimet policore...”.

Neni 3

Në nenin 7, pas togfjalëshit “me veprimet e tyre...”, të shtohet togfjalëshi “ose mosveprimet e tyre...”.

Neni 4

Në pikën 4, të nenit 10, emërtimi “...grada...” zëvendësohet me emërtimin “...funksionet...”.

Neni 5

Në pikën 3, të nenit 18, fjalët "...me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm..." zëvendësohen me fjalët "...me udhëzim të ministrit të Mbrojtjes..."

Neni 6

Në pikën 3, të nenit 20, fjalët "miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm" zëvendësohen me fjalët "... me udhëzim të ministrit të Mbrojtjes".

Neni 7

Pas germës "c", të nenit 21, të shtohet germa "ç", me këtë përmbajtje

"ç) për të dhënë deklarime rreth rrethanave të ngjarjes."

Neni 8

Në germën "b", të pikës 1, të nenit 29, pas fjalës "të ndaluar", të shtohet togfjalëshi "plotëson në sistemin përkatës të Policisë së Shtetit."

Neni 9

Në germën "f", të nenit 33, fjalët "mbron pronën shtetërore në administrim dhe përdorim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë nga veprimtari të kundërligjshme" zëvendësohen me fjalët "mbështet mbrojtjen e pronës dhe pasurisë shtetërore në administrim dhe përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë nga veprimtari të kundërligjshme".

Neni 10

Në germën "k", të nenit 33, shtohet fjalia "lista e personave dhe funksioneve që gëzojnë të drejtën e shoqërimit dhe sigurimit nga Policia Ushtarake, përcaktohet me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura".

Neni 11

Germa "n", e nenit 33, ndryshon dhe bëhet:

"n) kontrollon masat parandaluese, jep asistencë teknike dhe ndërhyr për forcimin e masave dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri".

Neni 12

Pas pikës 3, të nenit 36, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Policia Ushtarake nuk mund të japë informacion për çështje në hetim gjatë fazës së hetimeve paraprake për procedimet penale të regjistruara në prokuroritë përkatëse, sipas kodit të procedurës penale .”

Neni 13

Pika 1, e nenit 39, ndryshon dhe bëhet:

“1. Gjatë përmbushjes së detyrave të caktuara me ligj, punonjësi i Policisë Ushtarake zbaton rregulloren e brendshme të Policisë Ushtarake, të miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.”

Neni 14

Në pikën 3, të nenit 41, fjalët “...në masën e gjysmës së pagës mujore” ndryshohen dhe bëhen “në masën e një page mujore...”.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Lindita Nikolla